

## PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Punë

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Ndërtim pikash të reja për vendqëndrimin e koshave”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 5,831,130.05** (pesëmilion e tetëqindetridhjetenjë mijë e njëqindetridhjetë pikë zeropesë) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor: **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

##### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

##### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

##### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

**2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për ekzekutimin e kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente, liçensë për zbatim punimesh:**

| Kategoria | Klasifikimi | Emërtimi                                                                                                                                                   |
|-----------|-------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| NP 1      | A           | Punime gërmimi në tokë                                                                                                                                     |
| NP-2      | A           | Ndërtime civile dhe industriale                                                                                                                            |
| NS-4      | A           | Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastike, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese |
| NS-6      | A           | Sinjalistika rrugore jo ndriçuese                                                                                                                          |

*Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë autoritetit kompetent, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

*Gjithashtu operatori ekonomik duhet të ketë:*

*- Në zbatim të VKM nr. 28, datë 20.01.2016 “Për shpalljen e Qendrës Historike Himarë”, si dhe Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, punimet e zbatimit që do të kryhen në qytetin Himarë, janë pjesë e zonës së Qendrës Historike të këtij qyteti dhe operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar në përputhje me Ligjin Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” me kategorinë N-Z/A/7 “Për ndërhyrje në zonat muzeale/qendrat historike.*

*- Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombetare e Liçencimit II.8.B “Shërbime ndërhyrëse higjeno-sanitare: Dizifektim, Deratizim, Dizinsektim.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, nenin 39, pika 6, gërma (a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”, Ligjin Nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 të ndryshuar, VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar.*

*Në bazë të licencës profesionale të shoqërisë tregohet aftësia teknike e profesionale e realizimit të kontratës që prokurohet dhe pikat e kërkuara të licensës janë përcaktuar nga vlera e punimeve që do të realizohen si dhe nisur nga natyra e punëve që do të kryhen sipas zërave të preventivit. Nisur nga fakti që vlera e objektit është më e vogël se 20 milion lekë për kategoritë e punimeve, është zgjedhur niveli i klasifikimit ”A” që i përgjigjet kësaj vlere.*

*Në zbatim të VKM nr. 28, datë 20.01.2016 “Për shpalljen e Qendrës Historike Himarë”, si dhe Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, punimet e zbatimit që do të kryhen ne varrezat e qytetit Himarë, janë pjesë e zonës së Qendrës Historike të këtij qyteti dhe për këtë arsye është kërkuar që operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar në përputhje me Ligjin Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” me kategorinë N-Z/A/7 “Për ndërhyrje në zonat muzeale/qendrat historike.*

*Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit, që në këtë rast është ndërtimi i pikave të reja për vendqëndrimin e koshave në një zonë urbane me ndjeshmëri të veçantë.*

Nga pikëpamja teknike, kërkesa për licenca të kategorive NP-1, NP-2, NS-4 dhe NS-6 është e arsyeshme sepse punimet që do të kryhen nuk janë të thjeshta apo vetëm vendosje elementësh, por përfshijnë një proces të plotë ndërtimor. Fillimisht kërkohen punime gërmimi dhe përgatitje terreni, të cilat mbulohen nga kategoria NP-1. Më pas ndërtohen struktura bazë si platforma apo elementë mbajtës, që bien në fushën e ndërtimeve civile dhe industriale sipas NP-2. Përfundimi i këtyre strukturave kërkon punime rifiniture me materiale të ndryshme si dru, metal apo plastikë, çka justifikon kërkesën për NS-4. Ndërkohë, duke qenë se këto pika kanë funksion publik dhe orientues, përfshihet edhe vendosja e sinjalistikës përkatëse, e mbuluar nga kategoria NS-6. Në këtë mënyrë, çdo licencë e kërkuar lidhet konkretisht me një fazë të caktuar të zbatimit të kontratës dhe garanton që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm teknik për realizimin e plotë të punimeve.

Një element me rëndësi të veçantë është fakti që punimet zhvillohen në qytetin e Himarës, i cili është shpallur zonë me status të mbrojtur si Qendër Historike në bazë të VKM nr. 28, datë 20.01.2016. Për këtë arsye, kërkesa që operatori të jetë i pajisur me licencën specifike për ndërhyrje në zona historike, sipas kategorisë N-Z/A/7 të parashikuar nga Ligji Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, nuk është thjesht një kriter shtesë, por një detyrim ligjor. Ky ligj kërkon që çdo ndërhyrje në zona të mbrojtura të kryhet nga subjekte të specializuara dhe të licencuara posaçërisht, në mënyrë që të ruhet integriteti historik, arkitektonik dhe kulturor i zonës. Në këtë kuadër, kriteri synon të parandalojë ndërhyrje të papërshtatshme që mund të dëmtojnë vlerat e trashëgimisë kulturore.

Po ashtu, kërkesa për licencën e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për shërbime higjeno-sanitare të tipit dezinfektim, deratizim dhe dezinfektim lidhet me funksionin e vetë objektit të prokurimit. Duke qenë se bëhet fjalë për pika të grumbullimit të mbetjeve urbane, aspekti i higjienës publike është i lidhur ngushtë me përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Kjo kërkesë synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë kapacitetin për të ndërhyrë në mënyrë profesionale edhe në aspektin sanitar, duke reduktuar rreziqet për shëndetin publik dhe ndikimin negativ në mjedis. Në aspektin ligjor, kriteri është në përputhje me parimet themelore të prokurimit publik, pasi është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe synon të verifikojë aftësinë reale të operatorëve për ta realizuar atë. Gjithashtu, përfshirja e mundësisë për njehsimin e licencave për operatorët e huaj tregon respektimin e parimit të mosdiskriminimit dhe hapjes ndaj konkurrencës ndërkombëtare, duke u dhënë mundësi subjekteve të huaja të marrin pjesë në procedurë në kushte të barabarta, për sa kohë plotësojnë standardet e kërkuara.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

*2.2.1 OE duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros vjetore duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapacitetit financiar konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që

operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërket nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...”; nenin 43 pika 2/c dhe pika 3, nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohen se:

“2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërket operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme”.

“3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

“Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomikë dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërket operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”.

Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron është vendosur konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për:**

- një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 29 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore;
- Aktin e kolaudimit;
- Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.

**Shënim:** Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore;
- Akt kolaudimi objekti.

Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku parashikohet se ”Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: a) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar është përcaktuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

---

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) persona, gjatë muajit Shkurt 2026.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

- Listëpagesën sipas formularit satandart për sigurimet për muajin Shkurt 2026.

- Vërtetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar për muajin Shkurt 2026.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6.

*Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.*

Kriteri lidhet drejtpërdrejt me natyrën, volumet dhe organizimin e punimeve të parashikuara në specifikimet teknike.

Nga pikëpamja teknike, punimet e përshkruara nuk janë të një natyre të thjeshtë apo të përqendruar në një aktivitet të vetëm, por përbëjnë një proces të plotë ndërtimor që përfshin disa faza që zhvillohen paralelisht dhe kërkojnë specializime të ndryshme. Fillimisht parashikohen punime gjurmimi, transport materialesh dhe pastrim i terrenit, të cilat kërkojnë punëtorë fizikë dhe organizim të vazhdueshëm në terren. Më pas vijnë punimet e betonit dhe betonarmeve, që kërkojnë staf të kualifikuar për përgatitjen, hedhjen dhe vibrimin e betonit, si dhe për realizimin e armaturave dhe kallëpeve sipas projektit. Paralelisht me këto procese zhvillohen punimet metalike për parapetet, rifiniturat si shtresat e llustrës së çimentos dhe lysterjet, si dhe vendosja e elementëve të sigurisë dhe sinjalistikës.

Në të njëjtën kohë, kontraktori ka detyrime të vazhdueshme për mobilizimin e kantierit, mirëmbajtjen e tij, garantimin e kushteve higjieno-sanitare, mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë në punë. Këto përfshijnë organizimin e hyrje-daljeve në kantier, vendosjen e barrierave dhe sinjalistikës për publikun, kontrollin e ndotjes, si dhe pastrimin dhe dezinfektimin e vazhdueshëm të zonës së punimeve. Po ashtu kërkohet prezencë për mbikëqyrje, koordinim dhe zbatim të masave të sigurisë për të shmangur aksidentet dhe ndërhyrjet në trafikun normal. Të gjitha këto procese nuk mund të realizohen në mënyrë efikase dhe brenda afateve kontraktuale me një numër të kufizuar punonjësish.

Pikërisht për këtë arsye, përcaktimi i një minimumi prej 15 punonjësish synon të garantojë që operatori ekonomik ka kapacitet organizativ dhe njerëzor për të përballuar njëkohësisht disa fronte pune, për të respektuar standardet teknike dhe për të zbatuar kërkesat për siguri dhe mbrojtje të mjedisit. Ky numër konsiderohet proporcional me kompleksitetin e punimeve dhe shmang rrezikun e vonesave, punimeve me cilësi të dobët apo mosrespektimit të kushteve të sigurisë.

Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me aftësinë teknike dhe profesionale të operatorit për të realizuar kontratën. Kërkesa për vetëdeklarim fillestar dhe për dorëzim të dokumentacionit provues vetëm nga operatori i renditur i pari është gjithashtu në përputhje me praktikat standarde procedurale, duke shmangur ngarkesën administrative të panevojshme për operatorët e tjerë dhe duke garantuar njëkohësisht verifikim të plotë për fituesin e mundshëm.

Dokumentet e kërkuara, si listëpagesa dhe vërtetimi nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar, përbëjnë prova objektive dhe të verifikueshme që vërtetojnë jo vetëm ekzistencën e fuqisë punëtore, por edhe formalizimin e saj në përputhje me legjislacionin fiskal dhe të sigurimeve shoqërore. Kjo shmang përdorimin e fuqisë punëtore informale dhe garanton që punimet do të kryhen nga staf i rregullt dhe i mbuluar ligjërisht.

Për të justifikuar në mënyrë teknike numrin minimal prej 15 punonjësish, është e nevojshme të bëhet një ndarje konkrete e proceseve të punës sipas zërave të preventivit dhe mënyrës së organizimit të kantierit, duke marrë në konsideratë që një pjesë e punimeve kryhen paralelisht dhe jo në mënyrë lineare.

Nga analiza e punimeve rezulton se kantieri nuk mund të funksionojë me një ekip të vetëm, por kërkon disa grupe pune njëkohësisht.

Fillimisht, për punimet e gërmimit dhe përgatitjes së terrenit, që përfshijnë zbankim, rrafshim, transport manual të materialit dhe pastrim, kërkohen minimalisht 3 punonjës. Kjo sepse një punëtor nuk mund të kryejë njëkohësisht gërmimin, largimin e materialit dhe sistemimin e sipërfaqes, dhe procesi kërkon ritëm për të mos bllokuar fazat pasuese.

Për punimet e betonit dhe betonarmeve, duke përfshirë përgatitjen, transportin, hedhjen, vibrimin dhe nivelimin e betonit, si dhe vendosjen e armaturës dhe kallëpeve, nevojiten minimalisht 4 punonjës. Konkretisht, një për përgatitjen/organizimin e betonit, dy për vendosjen dhe shpërndarjen, dhe një për vibrimin dhe kontrollin teknik të sipërfaqes. Këto procese duhet të kryhen në të njëjtën kohë për të garantuar cilësinë e betonit.

Për realizimin e strukturave metalike (parapete, kangjella), prerje, montim dhe fiksim në vend, kërkohen të paktën 2 punonjës të specializuar, pasi këto punime nuk mund të realizohen nga një person i vetëm për shkak të peshës së elementëve dhe nevojës për saktësi në montim.

Për shtresat përfundimtare si llustra e çimentos dhe lyster me bojë, që kërkojnë përgatitje sipërfaqeje dhe aplikim të njëtrajtshëm, nevojiten minimalisht 2 punonjës për të ruajtur ritmin dhe cilësinë e punës. Njëkohësisht, për pastrimin dhe dezinfektimin e zonës, që është i domosdoshëm si në fillim ashtu edhe gjatë dhe në fund të punimeve, kërkohen të paktën 2 punonjës, duke pasur parasysh se këto aktivitete nuk mund të ndërpriten dhe duhet të zhvillohen paralelisht me fazat e tjera. Për sigurimin teknik të kantierit dhe mbrojtjen e publikut, sipas specifikimeve (vendosje barrierash, sinjalistikë, kontroll i hyrje-daljeve, monitorim i trafikut), nevojitet minimalisht 1 person i dedikuar, i cili nuk mund të jetë i angazhuar njëkohësisht në procese ndërtimore.

Gjithashtu, kërkohet të paktën 1 person për drejtimin teknik dhe organizimin e punimeve (p.sh. përgjegjës kantieri ose teknik), i cili koordinon grupet e punës, ndjek zbatimin e projektit dhe komunikon me mbikëqyrësin.

Ky numër përfaqëson minimumin e nevojshëm për të garantuar që punimet të zhvillohen paralelisht, me cilësi dhe në përputhje me kërkesat për siguri, mjedis dhe afate. Një numër më i ulët do të detyronte operatorin të kryente proceset në mënyrë të fragmentuar, duke rritur rrezikun e vonësive, uljes së cilësisë dhe mosrespektimit të kushteve teknike të kontratës.

*2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë drejtuesin teknik që do të ndjekë punimet e kësaj kontrate, i cili gjatë zbatimit të kësaj kontrate nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera të lidhura nga ky operator ekonomik.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Operatori ekonomik kërkohet të përcaktojë një drejtues teknik të dedikuar për këtë kontratë, në mënyrë që të sigurohet mbikëqyrje e vazhdueshme dhe profesionale gjatë gjithë procesit të zbatimit të punimeve. Kërkesa që ky drejtues teknik të mos jetë i angazhuar njëkohësisht në kontrata të tjera lidhet drejtpërdrejt me nevojën për fokus maksimal, disponueshmëri të plotë dhe reagim të shpejtë ndaj problematikave që mund të lindin gjatë zbatimit. Nëse drejtuesi teknik do të ishte i përfshirë në disa projekte njëkohësisht, do të rritej rreziku i mungesës së vëmendjes, vonesave në vendimmarrje dhe uljes së cilësisë së mbikëqyrjes teknike. Kjo mund të ndikojë negativisht në përmbushjen e afateve, standardeve teknike dhe kërkesave kontraktuale. Ky kriter synon të mbrojë interesin publik duke siguruar që kontrata të realizohet me standarde të larta cilësie, efikasitet dhe përgjegjshmëri, duke minimizuar rreziqet që lidhen me menaxhimin e pamjaftueshëm teknik.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

- |                   |         |
|-------------------|---------|
| ➤ Agronom         | 1 (një) |
| ➤ Teknik Ndërtimi | 1 (një) |
| ➤ Murator         | 1 (një) |
| ➤ Karpantier      | 1 (një) |
| ➤ Saldator        | 1 (një) |

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:

- Kontratë individuale të punës (të vlefshme)
- Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme), të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi të njohur nga Republika e Shqipërisë, Institucione Shtetërore ose organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë.
- Për agronomin, diploma ose listë notash.
- Për teknikun e ndërtimit, diplomë ose listë notash.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit” si dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", Urdhërin Nr. 109, datë 05.08.2013 ”Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, pasi për kryerjen e punimeve të veçanta sipas zërave të preventivit kërkojnë specialistët e sipërpërmendur.*

*Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve, volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr.15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”.*

*Kërkesa për disponimin e personelit kryesor të përbërë nga një agronom, një teknik ndërtimi, një murator, një karpentier dhe një saldator lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve dhe kompleksitetin e zbatimit të kontratës për ndërtimin e pikave të vendqëndrimit të koshave.*

*Nga pikëpamja teknike, ky objekt prokurimi nuk përfshin vetëm punime të thjeshta ndërtimi, por një ndërthurje aktivitatesh që kërkojnë njohuri të specializuara dhe ndarje të qartë rolesh në kantier. Prania e një tekniku ndërtimi është thelbësore për organizimin, ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të punimeve sipas projektit dhe specifikimeve teknike, si dhe për koordinimin me mbikëqyrësin dhe autoritetin kontraktor. Ai siguron që çdo fazë, nga germimi deri te rifiniturat, të realizohet në përputhje me standardet dhe vizatimet, duke shmangur devijimet dhe gabimet që mund të sjellin pasojë në cilësi dhe kosto.*

*Muratori është i domosdoshëm për realizimin e elementëve bazë të ndërtimit, si shtresat e betonit, ilustrat e çimentos dhe përfundimet e sipërfaqeve, të cilat kërkojnë aftësi praktike dhe përvojë për të arritur një rezultat të qëndrueshëm dhe cilësor. Karpentieri është i nevojshëm për përgatitjen dhe vendosjen e kallëpeve për betonin, si dhe për çdo element të përkohshëm apo ndihmës në kantier*

që lidhet me strukturat mbajtëse dhe formësimin e betonit. Pa këtë rol, procesi i betonimit nuk mund të realizohet në mënyrë korrekte dhe sipas dimensioneve të projektit.

Saldatori është i domosdoshëm për realizimin dhe montimin e elementëve metalikë, si parapetet dhe kangjellat, të cilat kërkojnë prerje, lidhje dhe fiksime me saktësi dhe qëndrueshmëri. Këto punime kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë dhe jetëgjatësinë e strukturave, ndaj kërkojnë personel të kualifikuar dhe të certifikuar.

Prania e agronomit lidhet me faktin që punimet zhvillohen në mjedis urban ku ndërhyrjet ndikojnë drejtpërdrejt në terren, gjelbërim dhe mjedis. Përgatitja e terrenit, menaxhimi i tokës, mbrojtja e mjedisit dhe rikthimi i zonës në gjendje të pranueshme pas përfundimit të punimeve kërkojnë njohuri specifike në fushën e agronomisë. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme duke pasur parasysh kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes gjatë zbatimit të punimeve, siç parashikohet në specifikimet teknike.

Ky kriter synon të verifikojë kapacitetin profesional të operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në mënyrë të rregullt dhe cilësore. Kërkimi i dokumentacionit provues, si kontratat e punës, dëshmitë e kualifikimit dhe diplomat përkatëse, garanton që ky personel jo vetëm të ekzistojë, por të jetë realisht i kualifikuar dhe i përfshirë në strukturën e operatorit. Kjo shmang deklaratimet fiktive dhe rrit sigurinë që kontrata do të zbatohet nga staf i specializuar.

*2.3.5 Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:*

- *Certifikat e sistemit të menaxhimit të cilësive ISO 9001 : 2015 ose ekuivalente*
- *Certifikat e sistemit të menaxhimit të mjedisit ISO 14001 : 2015 ose ekuivalente*
- *Certificate për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001 : 2018 ose ekuivalente*
- *Certifikate e sistemit të integruar të menaxhimit BS PASS 99 : 2012 ose ekuivalente*
- *Për formim dhe trajtim personash mbi shëndetin dhe sigurinë në punë për rrezikun e lartë subjekti duhet të ketë minimalisht 1 (një) person, i cili duhet të jetë i pajisur me certifikatën “Përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë”*

*Në rastet e bashkimit ekonomik të operatorëve, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë përkatësisht certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Kontratës së Bashkëpunimit.*

*Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale”*

*“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara*

*nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit”.*

nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lid, janë kërkuar këto certifikata me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit”.

Kërkesa për paraqitjen e certifikatave të sistemeve të menaxhimit si ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018 dhe BS PASS 99:2012, si dhe disponimi i një personi të certifikuar për sigurinë dhe shëndetin në punë, lidhet drejtpërdrejt me garantimin e cilësisë së punimeve, mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë në kantier.

Nga pikëpamja teknike, natyra e punimeve për ndërtimin e pikave të vendqëndrimit të koshave përfshin procese që kërkojnë kontroll të vazhdueshëm të cilësisë, duke filluar nga përgatitja e terrenit, punimet e betonit, strukturat metalike, rifiniturat dhe deri te pastrimi dhe dezinfektimi i zonës. ISO 9001:2015 është drejtpërdrejt i lidhur me këtë aspekt, pasi garanton që operatori ekonomik ka të implementuar procedura të standardizuara për menaxhimin e cilësisë, kontrollin e proceseve dhe përmirësimin e vazhdueshëm, duke ulur rrezikun e punimeve me defekte apo mosrespektim të specifikimeve teknike.

Në të njëjtën kohë, vetë objekti i punimeve lidhet ngushtë me mjedisin urban dhe menaxhimin e mbetjeve, çka e bën të domosdoshme që operatori të ketë një sistem të menaxhimit mjedisor. ISO 14001:2015 siguron që aktivitetet në kantier, si gërmimet, transporti i materialeve, përdorimi i betonit dhe dezinfektimi, të kryhen duke minimizuar ndotjen e tokës, ajrit dhe zhurmës, si dhe duke respektuar kërkesat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në specifikimet teknike.

Një element kritik i këtij projekti është siguria në punë dhe mbrojtja e publikut, duke qenë se punimet zhvillohen në ambiente të hapura dhe potencialisht pranë qarkullimit të njerëzve dhe mjeteve. ISO 45001:2018 lidhet drejtpërdrejt me këtë aspekt, pasi garanton që operatori ka struktura dhe procedura për identifikimin e rreziqeve, parandalimin e aksidenteve dhe menaxhimin e kushteve të sigurta të punës. Kjo është në përputhje edhe me kërkesat e specifikimeve teknike që parashikojnë vendosjen e barrierave, sinjalistikës dhe masave mbrojtëse gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve.

Kërkesa për certifikatën BS PASS 99:2012 për sistemin e integruar të menaxhimit është një element që siguron se operatori ekonomik nuk i trajton këto standarde në mënyrë të fragmentuar, por i ka të integruara në një sistem të vetëm funksional. Kjo rrit efikasitetin e organizimit të kantierit dhe garanton koordinim më të mirë ndërmjet cilësisë, mjedisit dhe sigurisë në punë, gjë që është veçanërisht e rëndësishme në projekte me disa procese paralele si ky.

Sa i përket kërkesës për një person të pajisur me certifikatën “Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, ajo është drejtpërdrejt e lidhur me nivelin e rrezikut që paraqesin punimet ndërtimore, të cilat përfshijnë gërmime, punime betoni, punime në metal dhe përdorim pajisjesh. Prania e një personi të specializuar në këtë fushë garanton zbatimin konkret të masave të sigurisë

në terren dhe nuk mund të zëvendësohet nga role të tjera, pasi kërkon njohuri specifike dhe përgjegjësi të dedikuar.

Këto kërkesa synojnë të verifikojnë kapacitetin teknik dhe organizativ të operatorit për të realizuar kontratën sipas standardeve të kërkuara. Kërkesa që certifikatat të jenë të lëshuara nga organe të akredituara garanton vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre, ndërsa parashikimi për bashkimet e operatorëve ekonomikë siguron që çdo anëtar të mbulojë me certifikim pjesën e punimeve që merr përsipër, duke ruajtur proporcionalitetin dhe funksionalitetin e kriterit.

*2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:*

|                                                                   |                |                            |
|-------------------------------------------------------------------|----------------|----------------------------|
| <i>Kamion veteshkarkues me vinc kapacitet mbajtës (mbi 5 ton)</i> | <i>1 copë</i>  | <i>pronësi ose me qera</i> |
| <i>Kamioncinë me kapacitet mbajtës (deri 3 ton)</i>               | <i>1 copë</i>  | <i>pronësi ose me qera</i> |
| <i>Eskavator me goma</i>                                          | <i>1 copë</i>  | <i>pronësi ose me qera</i> |
| <i>Motobetoniere</i>                                              | <i>1 copë</i>  | <i>pronësi ose me qera</i> |
| <i>Depozitë uji <math>\geq 5000</math> litra</i>                  | <i>1 copë</i>  | <i>pronësi ose me qera</i> |
| <i>Kokore</i>                                                     | <i>10 copë</i> | <i>pronësi ose me qera</i> |
| <i>Pompe uji</i>                                                  | <i>1 copë</i>  | <i>pronësi ose me qera</i> |
| <i>Kuti e ndihmës së shpejtë</i>                                  | <i>5 copë</i>  | <i>pronësi ose me qera</i> |

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.*

*Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:*

*a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:*

- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit;*
- leje qarkullimi;*
- certifikaten e kontrollit teknik;*
- siguracionin e mjetit.*

*b) Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet:*

- dokumenti që vërteton regjistrimin e tij;*
- leje qarkullimi;*
- certifikaten e kontrollit teknik,*
- siguracionin e mjetit.*

*Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.*

*Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

*Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkaëse.*

*c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

*d) Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës që prokurohet dhe afati i saj.*

- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- f) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.
- g) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedura të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Lloji dhe numri i mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës është përcaktuar duke u bazuar në zerrat e preventivit dhe specifikimeve teknike. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Përcaktimi i paisjeve dhe makinerive është bërë duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit, mundësive të manovrimit me mjete të rënda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj.

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes, Kontratës së Qirasë apo Huapërdorjes. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit). Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë një seri mjeteve dhe pajisjesh specifike, përfshirë kamionë vetëshkarkues, kamionçina, eskavator, motobetoniere, depozitë uji, kokore, pompe uji

dhe kuti ndihmëse, është teknikisht e justifikuar dhe e domosdoshme për realizimin e objektit të prokurimit, që është ndërtimi i pikave të vendqëndrimit të koshave. Ky objekt përfshin një gamë të gjerë punimesh ndërtimore dhe logjistike, të cilat kërkojnë mobilizimin e kantierit, transportin e materialeve, përgatitjen e terrenit dhe punime të betonit dhe metalike, si dhe menaxhimin e ujit dhe mbrojtjen e punëtorëve dhe publikut.

Kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbi 5ton është i nevojshëm për transportin dhe shpërndarjen e materialeve voluminoze si zhavorri, rërat, guri dhe beton i përzier, duke siguruar ritëm dhe efikasitet në kantier. Kamionçina me kapacitet deri në 3ton është e domosdoshme për transportin e materialeve më të vogla dhe mjetet ndihmëse në zonat ku qarkullimi është i kufizuar, duke mundësuar që të gjitha proceset të kryhen pa ndërprerje dhe me kohëzgjatje optimale. Eskavatori me goma është një pajisje kyçe për gjërmimet, nivelimin dhe përgatitjen e terrenit, duke mundësuar kryerjen e punimeve të tokës me shpejtësi dhe saktësi, të cilat nuk mund të arrihen manualisht pa një numër shumë më të madh punonjësish dhe pa rrezik për vonesa dhe defekte.

Motobetonieret janë të domosdoshme për përgatitjen dhe transportin e betonit në vendin e punës në mënyrë të vazhdueshme dhe të kontrolluar, duke garantuar cilësinë e betonit të hedhur, ndërsa depozita e ujit me kapacitet mbi 5000 litra dhe pompa e ujit sigurojnë furnizimin me ujë të nevojshëm për përzierjen e betonit, larjen e sipërfaqeve dhe dezinfektimin e kantierit, duke përmbyshur kërkesat për higjienë dhe cilësi. Kokoret dhe kutitë e ndihmës së shpejtë sigurojnë pajisjet bazë për realizimin e punimeve të përkohshme dhe për trajtimin e incidentëve të mundshëm, duke mbrojtur shëndetin e punonjësve dhe sigurinë në kantier.

Disponimi i këtyre mjeteve siguron që punimet të kryhen në kohë, me cilësi të lartë dhe në përputhje me projektin dhe specifikimet teknike, pa ndërprerje apo vonesa të shkaktuara nga mungesa e pajisjeve kritike. Çdo proces, që nga transporti i materialeve, përgatitja e betonit, punimet e gjërmimit, vendosja e strukturave metalike dhe rifiniturat, kërkon pajisje të specializuara, dhe mungesa e ndonjëres prej tyre do të reduktonte ritmin e punës dhe do të rrezikonte realizimin e kontratës brenda afateve dhe standardeve të kërkuara.

Vetëdeklarimi i mjeteve, shoqëruar me dokumentacionin provues të pronësisë ose qerasë, çertifikatat e kontrollit teknik, lejet e qarkullimit dhe siguracionin, garanton verifikueshmërinë e disponueshmërisë së tyre dhe shmang manipulimet. Kërkesa që mjetet të jenë të lirë nga angazhime të tjera dhe të jenë të vendosura në lokacione të kontrollueshme siguron që ato do të jenë të gatshme për përdorim gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Afatet e realizimit të punimeve: Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës.

Specifikimet teknike, grafiku i ekzekutimit të punimeve, profilet e detajeve si dhe relacioni teknik janë hartuar nga projektuesi në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet profesionale në fuqi, duke reflektuar në mënyrë të plotë dhe të detajuar të gjitha elementet e nevojshme për realizimin korrekt të objektit të kontratës; këto dokumente do t'i bashkëlidhen dokumentacionit të tenderit si pjesë përbërëse dhe thelbësore e tij, ndërkohë që preventivi është integruar si komponent i pandashëm i këtyre materialeve, duke pasqyruar në mënyrë të strukturuar dhe të argumentuar vlerësimin ekonomik të punimeve që do të kryhen.

Specifikimet teknike paraqesin në mënyrë të qartë dhe të detajuar minimumin e kërkesave dhe njëkohësisht tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, të cilat garantojnë nivelin e kërkuar të cilësisë, funksionalitetit dhe qëndrueshmërisë së punimeve, duke siguruar që çdo produkt, material apo shërbim i ofruar të jetë i përshtatshëm për qëllimin e parashikuar dhe të përmbushë plotësisht funksionet për të cilat kërkohet.

Këto specifikime janë hartuar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe me nenin 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), duke garantuar transparencë, mosdiskriminim, trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe një bazë të qartë dhe të unifikuar për vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**